

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË " SOLEN Energy " SH.P.K.

Sot, me datë 08/02/2023

Z. Agron Kovaçi, shtetas Shqiptar, lindur më 28/11/1973 në Breg-Lume, Shqiperi, mbajtës I kartes se Id me nr. 033876587 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " **Solen Energy Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Solen Energy" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën Tirane, Tirane Kamez, Rruga Kosova, Zona Kadastrale 2066.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Projektim, ndertim, instalim dhe tregtimi i sistemeve te energjise se rinovueshme, parqeve e fermave diellore, parqet e erez nepermjet turbinave dhe i sistemeve hidro elektrike te shfrytezuara per vete ose per te tjeret Implementimi dhe menaxhimi I projekteve gjeneruese(fotovoltaike,eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise elektrike si dielli, era , uji si dhe i veprave te tyre ndihmese. Perfshire dhe pa u kushtezuar vetem ne marrjen e te gjithave lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake

perfundimtare, instituionet pergjegjese shteterore(qofshin keto organe Qendrore apo Vendore), apo private te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise . Ndermjetesim me komision per blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve te burimeve te energjise se rinovueshme, parqeve e fermave diellore, parqet e eres nepermjet turbinave dhe sistemeve hidro elektrike te 2 shfrytazuara per vete ose per te tjeret. Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret e energjise elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursa te tjera te Energjise jashte vendit..

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 10.000.000 Lek dhe është i ndarë në 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Agron Kovaçi** zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 10,000,000 Lek dhe 10,000,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Agron Kovaçi**, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z.Agron Kovaçi

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'A' and 'K' followed by a vertical line and a small hook at the bottom.